# DËSHMI ARKIVI

**A-444483**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 15 shtatori i Veliajt/Kush po luan lojën e madhe pas dyerve të Gjykatës së Lartë?! |
| ADRESA | `https://versus.al/aktualitet/15-shtatori-i-veliajt-kush-po-luan-lojen-e-madhe-pas-dyerve-te-gjykat-i46563` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 20:14:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 19:38:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `89c60713a5edd0b2c2fb2569f5f54d5f6af97b976e982292d9511f57ef285bb2` |
| TEKSTI | `49569a0fad590b08be5c377b9ec41948593fc139cb786b20db849ea2d07e7997` |
| PAMJA | `680a9ac2b15aba270783470dfd127f18b4e0194984f52adbc6b943bd350d0857` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `998d09885128f8b6891ac09143ee0524cab25d4d095cbe1ff11cb0ab77cdc609` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/998d09885128f8b6891ac09143ee0524cab25d4d095cbe1ff11cb0ab77cdc609`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POLITIKË

["S'është çështje inati...", Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot Parlamentin!]

14 Shtator 2026, 19:31

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në



Created and monetized by

AKTUALITET / 14 Shtator 2026, 21:38

# 15 shtatori i Veliajt/Kush po luan lojën e madhe pas dyerve të Gjykatës së Lartë?!

Veliaj ndodhet në paraburgim për korrupsion, ndërsa në dosjen që lidhet me të janë përfshirë edhe persona të rrethit të tij familjar dhe shoqëror, mes tyre vëllai, bashkëshortja, vjehrra, të afërm dhe persona të konsideruar përfitues pranë tij

Shkruar nga Versus




Prej disa ditësh opinioni publik po përgatitet për mundësinë që Erion Veliaj do të dalë nga qelia në 15 Shtator, duke u krijuar perceptimi se kryeqyteti nuk mund të funksionojë pa të. Madje është e dukshme se edhe disa media të huaja janë paguar për të mbajtur të njëjtën linjë editoriale në raport me çështjen e kryebashkiakut të Tiranës.

Veliaj ndodhet në paraburgim për korrupsion, ndërsa në dosjen që lidhet me të janë përfshirë edhe persona të rrethit të tij familjar dhe shoqëror, mes tyre vëllai, bashkëshortja, vjehrra, të afërm dhe persona të konsideruar përfitues pranë tij.

Ndërkohë, disa analistë thonë se prej muajsh, përmes ndryshimeve të adresuara në ligj, është përgatitur terreni që masa e sigurisë ndaj Veliajt të mund të zbutet.

Akuza të forta hidhen edhe ndaj një grupi mediash vendase, të cilat janë identifikuar si media të ushqyera me para të përfituara nga skemat që i atribuohen Erion Veliajt dhe me një pjesë të parave të të ashtuquajturve "Klodi" të inceneratorëve. Të njëjtat media po bëjnë spektakël mediatik në mbështetje të asaj që përshkruhet si një "disidencë e re": politikanë të akuzuar për korrupsion që paraqiten publikisht si viktima të diskriminimit politik.

Madje të njëjtat segmente që financojnë këto media mburren se tashmë kanë "blerë" gjyqtarët Sandër Simoni dhe Gent Shala, ndërsa për gjyqtarin e tretë pretendohet se "nuk pyet askush".

Megjithatë, ekuacioni që do të çonte në lirimin nga burgu të Erion Veliajt prishet në momentin kur në të futet komponenti i prokurorëve.

Këta te fundit prej disa vitesh po punojnë me ccështjen, ndërsa dosja përmban dhjetëra fashikuj me prova e dëshmi të cilat nuk ka interes publik (fort e pambështetur kjo ide, sidomos kur ligji rregullon zëvendësimin e ccdo zyrtari) që e justifikon sidomos në rastin e një zyrtari të lartë të arrestuar për disa akuza të rënda. Sepse në fund të kësaj historie nuk është vetëm liria apo paraburgimi i një politikani.

Është besueshmëria e drejtësisë shqiptare.

Dhe nëse 15 shtatori do të shënojë një kthesë në çështjen Veliaj, atëherë ajo ditë mund të tregojë shumë më tepër sesa fatin e një kryebashkiaku.

Kjo është pika ku 15 shtatori mund të bëhet një test shumë më i madh se vetë çështja Veliaj.

Një test për gjykatën.

Një test për SPAK-un.

Një test për mediat.

Dhe mbi të gjitha, një test për mënyrën se si funksionon drejtësia e re shqiptare kur përballë saj është një prej figurave më të fuqishme të politikës shqiptare.

Sepse në fund, pyetja nuk duhet të jetë:

"A do të lirohet Veliaj?"

Pyetja duhet të jetë:

"Kush do të vendosë më 15 shtator: ligji dhe provat, apo presioni i jashtëzakonshëm që po ndërtohet rreth këtij vendimi?"/**Versus.al**

View this post on Instagram

A post shared by Versus.al (@versusalbania)

Poll




AKTUALITET

["Lironi djemtë e Diasporës", qytetarët protestojnë tek Blloku i Sigurisë]

14 Shtator 2026, 21:54

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Raportet e Kosovës me Perëndimin mund të tronditen pas vendimit]

14 Shtator 2026, 21:44

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Rrahën një shtetas indian, policia greke arreston 2 shqiptarë si autorë të dhunës]

14 Shtator 2026, 21:09

^ekstrakti^




AKTUALITET

[U godit me grusht në bark nga polici, protestuesi: Erdha nga Anglia t'i bashkohem protestës që ta rrëzojmë këtë qeveri!]

14 Shtator 2026, 21:01

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Resorti në Rrjoll, Kokaj: Bashkim Ulaj ka ndryshuar emër nga “Blu Borgo” në “Baks Bay” për të tjetërsuar të vërtetën]

14 Shtator 2026, 20:35

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Sot 107 ditë revoltë qytetare, protestuesit: Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit!]

14 Shtator 2026, 20:19

^ekstrakti^



AKTUALITET

**"Bledar Bakaj më rrëmbeu dhe përdhunoi vajzën", ish-vjehrri akuza të rënda ndaj dajës së Zegjine Çaushit**

14 Shtator 2026, 19:47

^ekstrakti^



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.